



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE  
SPITALI RAJONAL “MEMORIAL” FIER  
NJËSIA E PROKURIMIT



Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Fier, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2023

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “SHËRBIM AKOMODIM PERSONELI”**

*- Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, për një periudhë nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër deri me date 31.12.2023.*

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**55110000-4 /Shërbime të akomodimit në hotele**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 39 592 000 pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Spitali Rajonal “Memorial” Fier, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT:**

**1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:**

- *c. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- *b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

**2. KANDIDATI/OFERTUESI DUHET TË DORËZOJË:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

- **Kriter 2.1.1** : Licencën përkatëse të lëshuar nga Organi kompetent për ushtrimin e aktivitetit.
- **Kriter 2.1.2** : Certifikata e klasifikimit ku përcaktohet kategoria dhe niveli perkates i struktures akomoduese , me afat vlefshmërie brenda afatit të ekzekutimit të kësaj kontrate.

**Argumentimi per Kriter 2.1.1 dhe Kriter 2.1.2** : Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, germa a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në mbështetje të ligjit Nr. 93/2015 “Për turizmin” ; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.89, datë 1.3.1993 “Për dhënien e licencave për ushtrimin e veprimtarive turistike”, të Udhëzimit të përbashkët Nr.1, datë 19.5.2003 “Mbi licencimin dhe kontrollin e ushtrimit të veprimtarisë turistike” pika 1 e tij, si dhe të Urdhërit të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr.267, Datë 24.07.2019 “Mbi miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese” , i ndryshuar, neni 8 i saj.

### **3. KAPACITETI EKONOMIK DHE FINANCIAR:**

**Kriteri 2.2.1** Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjatë **3 (tre) viteve** te fundit (**2020, 2021, 2022**), ku vlera e xhiros **për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e ulët se 39 592 000** lekë (pra kjo vlerë e xhiros minimale vjetore nuk tejkalon vlerën e parashikuar të kësaj kontrate).

**Argumentimi** : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.Referuar parashikimeve ligjore të nenit 43, pika 2, germa ”b”, për procedurat me objekt shërbime me fond limit ndërmjet kufirit të ulët dhe të lartë monetar, siç është rasti i kësaj procedure, maksimumi i xhiros vjetore të kërkuar nuk duhet të tejkalojë vlerën e parashikuar të kësaj kontrate.Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Kontraktor për besueshmerinë dhe qëndrueshmerinë e tij.

### **4. KAPACITETI TEKNIK:**

#### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**Kriteri 2.3.1** Dëshmi nga operatori ekonomik për shërbime të mëparshme të ngjashme për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të kryera gjatë tre viteve të fundit , në një vlerë jo më të ulët se **15 800 000** (pra kjo vlerë totale e kontratave të mëparshme të realizuara gjatë tre viteve të fundit , nuk tejkalon 40% të vlerës së parashikuar të kësaj kontrate).

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku e shënohet vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislativës në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë jo më shumë se 40% të vlerës së

parashikuar të kontratës, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK, referuar nenit 47 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” .

**Kriteri 4.2:**Operatori Ekonomik të ketë të punësuar të paktën 5 (pesë) të punësuar si: pastrues, kuzhinier, mirëmbjatës ose ekuivalente.Për këtë të paraqiten listëpagesat e punonjësve për të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e zhillimit të procedurës së prokurimit si dhe deklaratë e Operatorit Ekonomik.Gjithashtu për punonjës/punonjësit me pozicion ”kuzhinier” të paraqitet dokumenti/dokumenta për aftësitë teknike profesionale si: shkolla profesionale për këtë fushë apo certifikata trajnimi.

**Argumentimi** : Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Referuar natyres se shërbimeve që kërkohen të prokurohen sic jane akomodim dhe shërbimi i ushqimit/ vakti i mëngjesit eshte e nevojshme pasja e nje stafi teknik me pozicione si: pastrues, kuzhinier, mirëmbajtës etj. e vertetuar kjo ne baze te listëpagesave të punonjësve për të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e zhillimit të procedurës së prokurimit si dhe të deklaratës se plotësuar nga operatori ekonomik me qellim realizimin me sukses të kontrates. Ky numer minimal është kërkuar duke u bazuar ne llojin e këtyre shërbimeve ku është i nevojshëm pastrimi i dhomave të stafit turk qe do të akomodohen, mirëmbajtja e tyre si dhe gatimi tradicional turk për perosnelin turk që do të akomodohen për një periudhë 12 mujore.Si rrjedhim është e dosmodoshme që OE të ketë të punësuar një kuzhinier/kuzhiniere të kualifikuar.

**Kriteri 4.3 :** Operatori ekonomik duhet te paraqese vërtetimin që vërteton se plotëson kushtet higjieno sanitare, lëshuar nga Instituti i Shëndetit Publik.

**Argumentimi:** Ky kriter bazohet në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ne mbeshtetje te ligjit Nr. 93/2015 “Për turizmin” ; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.89, datë 1.3.1993 “Për dhënien e licencave për ushtrimin e veprimtarive turistike”, të Udhëzimit të përbashkët Nr.1, datë 19.5.2003 “Mbi licencimin dhe kontrollin e ushtrimit të veprimtarisë turistike” ; Urdhërit të Ministrit të Turzimit dhe Mjedisit nr.267, Datë 24.07.2019 “Mbi miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese” , i ndryshuar, si dhe në ligjin Nr. 10448, date 14.07.2011, ”Per lejet e mjedisit” i ndryshuar”, në nenin 10 ku parashikohet shprehimisht: “.....10.3. Inspektoriat i Sanitar Shtetëror, pas ekspertimit higjieno-shëndetësor, lëshon aktmiratim higjieno-sanitar për utrimin e veprimtarisë”

**Kriteri 4.4 :** Foto të brendshme dhe të jashtme të objektit.

**Argumentimi** : Ky kriter bazohet në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” paraqitja e të cilave vërteton se OE disponon kapacitete e nevojshme të këkuara sipas specifikimeve teknike që përfshijnë detaje të ambienteve të ndryshme të hotelit si: dhomat, tualetet, ambientet clodhëse etj.

**Kriteri 4.5:** Vendndodhja e hotelit të jetë jo më larg se 10 km me rrugë automobilistike nga Spitali Rajonal “Memorial” Fier. OE duhet të paraqesë certifikatë pronësie ose kontratë qiraje ose kontratë huapërdorje që vërteton vendndodhjen e Operatorit Ekonomik.

**Argumentimi:** Ky kriter bazohet në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, VKM nr. 58, datë 26.1.2022 “Për miratimin e Protokollit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, për funksionimin e përbashkët të Spitalit Rajonal “Memorial” në Fier, gjatë fazës kalimtare” , si dhe për shkak se personeli mjekësor dhe infermieror punojnë në Spitalin ”Memorial” Fier me turne për 24 orë.Kjo largësi vjen në përputhje me shërbimin e transportit të personelit turk nga hoteli në Spital për cdo ditë, i cili mbulohet nga Institucioni ynë.

**Kriteri 4.6 :** OE të ketë të punësuar një punonjës “përkthyes” të gjuhës turke.Për këtë të paraqitet kontratë pune me OE pjesëmarrës.

**Argumentimi :** Ky kriter bazohet në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” pasi numri maksimal i personelit turk që do të akomodohen në hotel është 38 në ditë, cka do të thotë që jo të gjithë punonjësit zotërojnë gjuhën angleze.Kjo kërkesë është e dosmosdoshme për zbatimin e kësaj kontrate me afat maksimal 12 muaj.

**Kriter 4.7:** Operatori duhet të ketë çertifikatën ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”/ekuivalente, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

**Argumentimi :**Në bazë të nenit 79/1 , të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” si dhe neneve 41/4/a si dhe 44/1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që Autoriteti ose enti kontraktor të vërtetojë se shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Bazuar në këto dispozita Autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë.

**Kriter 4.8** OE merr përsipër që në raste të emergjence shëndetësore të ekipit turk të vëjë në dispozicion një automjet 4+1 për transportin e personelit mjekësor (mjek/infermier) nga hoteli në Spitalin Rajonal “Memorial” Fier.Për automjetin të paraqitet:-Në rast se automjeti është në pronësi të OE të paraqitet leja e qarkullimit, certifikata e pronësisë, polica e sigurimit e vlefshme, -Në rast se autompjeti është me qera osë në përdorim të OE të paraqitet kontrata e qeramarrjes ose përdorimi si dhe dokumentat e pronarit të ligjshëm leja e qarkullimit, certifikata e pronësisë, polica e sigurimit e vlefshme,

**Argumentimi:** Në bazë të nenit 79/1 , të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” si dhe neneve 41/4/a si dhe 44/1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,vendosët ky kriter duke qënë se shumica e personelit turk që do të akomodohen janë mjekë dhe infermierë dhe në raste emergjencash është e nevojshme prania e tyre menjëherë pas lajmërimit pranë Spitalit ”Memorial” për dhënien e ndihmës së shpejtë ndaj pacientit/pacientëve, kur situata nuk mund të presë që transporti i mjekëve dhe infermierëve të kryhet nga automjetet në pronësi të Spitalit Rajonal ”Memorial” Fier.

## **5. Argumentimi i specifikimeve teknike:**

Bazuar në Vendimit e Këshillit të Ministrave nr. 58, datë 26.1.2022 “Për miratimin e Protokollit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, për funksionimin e përbashkët të Spitalit Rajonal “Memorial” në Fier, gjatë fazës kalimtare” neni 4 pika 3 e tij, një prej detyrimeve të palës shqiptare është

**3. “Të mbulojë shpenzimet akomodimit të personelit që do të emërohen në këtë projekt nga pala turke...”.**

Në zbatim të këtij detyrimi ligjor,

### **A. Fjetja përfshirë mëngjesin:**

#### **Për shërbimin e fjetjes:**

Operatori Ekonomik fitues duhet të mbulojë fjetje në dhoma standarte teke ose dyshe (double). Arredimi dhe mobilimi i dhomave duhet të ofrojë kushte optimale dhe të kënaqshme për qëndrimin/jetesën.

- Akomodimi në hotel do të jetë për maksimumi 40 (dyzetë) persona në natë
- Koha e qëndrimit: nga data e lidhjes së kontratës deri më 31.12.2023.
- Ngrohje dhe ftohje me kondicioner në dhomë dhe secila dhomë të ketë tualet
- Të jenë të përfshira vaktet: mëngjesi.

Pastërtia dhe higjiena janë themelore në të gjitha kategoritë. Ambienti të plotësojë kushtet e higjienës në të gjitha mjediset e brendshme dhe të jashtme të hotelit (dyshe, muret, tavanet, mobiljet, dyert, dritaret dhe çdo pajisje tjetër pa dëmtime, njolla dhe shenja të tjera) si dhe të jetë me termoizolim.

Të gjithë mekanizmat dhe pajisjet të jenë funksionale dhe në gjendje pune.

Të jetë i instaluar sistemi për mbrojtjen nga zjarri.

#### **• Dhomat:**

Sipërfaqja e dhomave të jenë të përshtatshme për aq persona sa do të akomodohen, duke përfshirë tualetin. Shtretërit të jenë me dyshek me teknologji bashkëkohore dhe të mirëmbajtur.

Seti i çarçafëve të jenë pambuk ose një cilësi tjetër e lartë. Mbulesat/jorganët të jenë me vatinë ose pupla ose ekuivalente. Modeli i jastëkut të jetë bashkëkohor dhe i mirëmbajtur. Dhomat të jenë me perde. Dhomat të kenë dollapë të përshtatshëm ose zgjidhje alternative për varjen rrobave dhe ndarje për rrobat e palosura gjithashtu dhe një numër të përshtatshëm varësesh rrobash.

Gjithashtu dhomat të kenë të paktën një karrige, një tavolinë, një prizë elektrike të aksesueshme në dhomë si dhe një televizor. Ndriçimi të jetë i përshtatshëm në dhomë me çelës kryesor në hyrje të dhomës.

Dhomat të jenë me ajër të kondicionuar / sistem ngrohjeje dhe ftohjeje efektive.

- **Tualetet :**

*Tualetet e të gjitha dhomave të jenë të gjitha me dush dhe VC ose vaskë dhe VC. Muret e tualeteve të jenë me material të papërshkueshëm nga uji që pastrohet lehtë (pllaka qeramike, rezinë etj.)*

*Dyshemeja e tualetit të jetë me material kundër rrëshkitjes dhe të padepërtueshëm nga uji (pllaka qeramike, rezinë e të ngjashme etj.) Lavamanët të jenë me ujë të rrjedhshëm, të ngrohtë dhe të ftohtë. Në çdo tualet të ketë pasqyrë, mbajtëse peshqiri horizontale ose në formë grepi, aksesore për mbajtjen e sendeve të tualetit, kosh mbeturinash, sapun i paketuar ose sapun i lëngshëm në kontenedorë, shampo trupi dhe flokësh, 1 peshqir të vogël për person, 1 peshqir të madh për person.*

- **Pastrimi dhomës dhe tualeteve në dhomë.**

*Ndërrim i përditshëm i peshqirëve sipas kërkesës të personelit. Ndërrim i çarçafëve minimalisht*

*1 (një) herë në 3 (tre) ditë dhe me kërkesë të personelit sipas rastit.*

- **Të ndryshme:**

*Të gjitha shërbimet të ofrohen nga personel i kualifikuar dhe i identifikueshëm. Hoteli merr përsipër të ofrojë çaj tradicional turk si dhe ujë të pijshëm pa limit sipas kërkesave të personelit turk. Vendndodhja e hotelit të jetë jo më larg se 10 km me rrugë automobilistike nga Spitali Rajonal “Memorial” Fier. Hoteli të ofrojë shërbim 24 orësh gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit të kontratës. Operatori ekonomik pjesëmarrës për arsye sigurie duhet të marrë përsipër ruajtjen e ambjentit dhe garantimin e sigurisë maksimale brenda ambjentit për ekipin turk duke siguruar ambjente të veçanta larg personave të tretë. Gjatë periudhës së ekzekutimit të kontratës, operatorin garanton që asnjë person i tretë nuk hyn/del në ambjentin ku akomodohet personeli turk. Hoteli garanton sigurimin e ambjentit të faljes për ekipin turk. Hoteli ofron ambient të veçantë sportiv dhe argëtimi si lojra shahu, domino, si dhe krijojnë një ambient të hapur relaksues për periudhën jozyrtare të punës për personelin turk. Hoteli merr përsipër që në rastet e festave zyrtare të shtetit turk të organizojë banketin e dedikuar për ekipin turk.*

**B. Për Vaktin e Mëngjesit:**

*Operatori Ekonomik fitues duhet të ofrojë ushqim për personelin turk për 1 vakt ditor (mëngjesin) me menu javore të ndryshme si dhe pije, vecanërisht ujë dhe çaj turk pa limit. Të ketë ambientin e posaçëm për shërbimin ofrimit të ushqimit. Menuja e mëngjesit, të jetë sipas kërkesës së punonjësve turq që do të akomodohen/gatim tradicional turk.*

**Argumentim:** Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Dokumentat e tenderit janë hartuar bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Referuar pikës 5 të nenit 82 të Ligjit 162 date 23.12.2020 “Për prokurimin publik” operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike si dhe dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna, jo me vone se 5 dite nga publikimi i njoftimit te fituesit përfundimtar.

Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: Data: 18.05.2023 Ora: 08:00; Vendi: [ëëë.app.gov.al](http://ëëë.app.gov.al), Spitali Rajonal “Memorial” Fier .

## **NJËSIA E PROKURIMIT**